

KËRKESË
Nr. 906/1, datë 9.3.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “ByPass-Vlorë (shitesa)” (faza e parë), për pasuritë e llojit “objekt”, “truall”, “arë”, “kullotë”, “ullishte”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit: “objekt”, “truall”, “arë”, “kullotë”, “ullishte”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Mini-strave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 237 038 644 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Eduart Seitaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY PASS-VLORË (shitesa) (faza e parë)

Nr.	PRONARI			Z. kad	Nr. i pasurisë	Sip. përgj. m ²	Sipërfaqe ndërtimi			Sipërfaqe truall			Vlefte totale në lekë	Konfirmimi
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. ndërtimi m ²	Sipërfaqe ndërtimi vlefte lekë/m ²	Vlefte sipërfaqe ndërtimi	Truall sip. m ²	Vlefte lekë/m ²	Vlefte truall në lekë		
1	ARBEN	RESUL	HAZIZAJ	8605	6/273	84	84	60120	5050080	84	8300	697200	5747280	Certifikatë pronësie
	SHUMA								5050080				5747280	